




Emri:		Nr. Dred:	
Titulli:		Emri i Dred:	01/2318/03
Dop:	DPK	Emri i Dred:	01.08.13
Emri i Dred:		Emri i Dred:	
Emri i Dred:		Emri i Dred:	
Emri i Dred:		Emri i Dred:	
Emri i Dred:		Emri i Dred:	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë **31.07.2013**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-445/13 për z.Arbnor Kastrati – Këshilltar Politik në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), sepse ai nuk ushtron më funksionin e zyrtarit të lartë publik.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-445-13, për Zyrtarin e lartë, z. Arbnor Kastrati – Këshilltar Politik në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-445/13, të hetuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari i lartë, z. Kastrati së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (Z.D.DPK-01-662/13), pas të cilës zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Kastrati është deklaruar se do të filloj shpejt procedurën për shmangien e kësaj shtate të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Meqense kishte kaluar kohë jashtë afateve të dhëna ligjore, dhe zyrtari i lartë nuk i ka bërë veprimet e duhura për të shmangur këtë shtatë, Agjencia kundër Korrupsionit, konform nenit 18 paragrafi 5 i Ligjit Nr.04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik i ka bërë edhe shkresën e dytë – Paralajmërimin (Z.D./ DPK-01-1795/13)

Ndërkohë, pas shkresës tonë të dytë, ztr. Kastrati ka ndrruar funksionin e tij dhe ai nuk është me në funksionin e Këshilltarit Politik në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, me çka ai nuk është me as zyrtar i lartë. Kjo është vërtetuar me rastin e deklarimit të pasurisë pas largimit nga funksioni.

Po ashtu në këtë shkresë zyrtare jemi njoftuar se që nga data 17.06.2013 ztr.Kastrati nuk e ushtron më detyrën e Këshilltarit Politik dhe natyrisht nuk është as zyrtar i lartë i shtetit.


Andaj , duke u bazuar në faktet dhe gjendjen reale, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /



Agjencia Kundër Korrupsionit / Agjencia protiv korupcije / Anti Corruption Agency

www.akk-rks.org ,